



Datë: 22.04.2026

A.nr.103/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Malsore Gashi Bajraktari anëtare, me Ilire Mehmeti-Shaqiri, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.103/2026, të datës 30.01.2026, të parashtruar nga ankuesi Z.R, kundër organit të punësimit, Ministrisë së Punëve të Brendshme, në çështjen juridike-administrative “*transferim*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3 dhe nenin 18, paragrafi 1, nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, në seancën për këshillim dhe votim të datës 22.04.2026, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa më numër A.nr.103/2026, e datës 30.01.2026, e parashtruar nga ankuesi Z.R.

II. Anulohet Vendimi me Nr.2402/2025, i datës 31.12.2025, i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

III. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Brendshme, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit, duke ndërmarr veprimet ligjore për kthimin e ankuesit në vendin e punës sipas akt emërimit me të gjitha të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim për veprimet e ndërmarra.

A r s y e t i m

Ankuesi Z.R (*tutje referuar ankuesi*), më datë 26.01.2026, përmes postës ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e pranuar më datë 30.01.2026, e regjistruar nën shenjë A.nr.103/2026, kundër Vendimit me Nr.2402/2025, të datës 31.12.2025, të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (tutje referuar vetëm Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 06.02.2026, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, ndërsa, ky i fundit, më datë 06.03.2026, i ka përcjellë shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (tutje referuar Kolegji i Këshillit) për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesën e me numër protokolli 505/2025 të datës 30.01.2025 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Vendimin me numër 2402 të datës 31.12.2025 për transferimin e përkohshëm të ankuesit; Kërkesën e datës 06.02.2025 për përgjigje në ankesë; Përgjigjen e datës 06.03.2026;

Kolegji i Këshillit, duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç, dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se ankesa është **e bazuar**, sepse:

Nga administrimi i provave materiale rezulton se Ankuesi sipas Aktit të Emërimit me shenjen Form-MJU/AE/01 të datës 12.07.2016, është i punësuar në pozitën Zyrtar Administrativ në Qendrën për Pajisje me Dokumente në Sektorin Qendra për Pajisje me Dokumente, Agjencia e Regjistrimit Civil në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Brendshme, më datë 31.12.2025, ka nxjerr Vendim me Nr. 2402/2025, me të cilin ka bërë transferimin e përkohshëm të ankuesit nga pozita Zyrtar Administrativ në Qendrën për Pajisje me Dokumente, në pozitën Asistent Administrativ në Qendrën për Pajisje me Dokumente në Vushtri.

Ankuesi, në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e kundërshton Vendimit me Nr.2402/2025, të datës 31.12.2025, të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme, pretendon se transferimi është bërë fillimisht pa njoftim paraprak me shkrim; Vendimi nuk është arsyetuar mbi gjendjen faktike përkatësisht nuk ka dhënë arsyetim nëse punonjësi i transferuar plotëson kriteret e pozimit ku transferohet; Transferimi duhet bazohet në atë se transferimi i përkohshëm për interes të institucionit është prej gjashtë muaj deri në 12 muaj gjatë dy viteve.

Kolegji i Këshillit, ndërlidhur me aktin kontestues, përkatësisht çështjen e transferimit të përkohshëm i'u referuar dispozitave të nenit 63 paragrafi 1 dhe 2, të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, ku përcaktohet: *1. Nëpunësja/i civil mund të transferohet përkohësisht në një pozitë tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori në këto raste: 1.1. kur është në interes të institucionit, prej gjashtë (6) deri në dymbëdhjetë (12) muaj gjatë dy (2) vjetëve; 1.2. për përmirësimin e rezultateve të punës të vetë nëpunëses/it që është vlerësuar sipas neni 52, paragrafi 13, nën-paragrafi 13.4. dhe 13.5, prej gjashtë (6) deri në dymbëdhjetë (12) muaj gjatë dy (2) vjetëve; 1.3. për arsye të përkohshme shëndetësore në bazë të vendimit të komisionit kompetent, sipas ligjit, për aq sa është e nevojshme, sipas vendimit të komisionit përkatës. 2. Transferimi mund të bëhet: 2.1. brenda institucionit ku është emëruar, duke përfshirë këtu edhe degët e tij lokale; 2.2. në një agjenci ekzekutive të institucionit ku është emëruar; 2.3. në një institucion tjetër, që punëson shërbyes civil.;* si dhe Rregullores (QRK) Nr. 02/2024 për

Transferimin e Nëpunësve Civilë, gjegjësisht nenit 4 paragrafi 1, 2 dhe 3, ku përcaktohet: *1. Nëpunësi civil mund të transferohet përkohësisht në një pozitë tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori në këto raste: 1.1. kur është në interes të institucionit, prej gjashtë (6) deri në dymbëdhjetë (12) muaj gjatë dy (2) viteve; 1.2. për përmirësimin e rezultateve të punës të vetë nëpunësit që është vlerësuar sipas nivelit “ka nevojë për përmirësim” apo “e papranueshme”, prej gjashtë (6) deri në dymbëdhjetë (12) muaj gjatë dy (2) viteve; 1.3. për arsye të përkohshme shëndetësore, për aq sa është e nevojshme sipas vendimit të komisionit përkatës. 2. Transferimi i përkohshëm si në paragrafin 1 të këtij neni mund të bëhet: 3.1. brenda institucionit ku është emëruar, duke përfshirë këtu edhe degët e tij lokale; 3.2. në një agjenci ekzekutive të institucionit ku është emëruar; 3.3. në një institucion tjetër, që punëson shërbyes civilë. 3. Transferimi i përkohshëm në një institucion tjetër të shërbimit civil bëhet përmes marrëveshjes paraprake në mes të institucionit ku nëpunësi është aktualisht i punësuar dhe institucionit ku nëpunësi transferohet.*

Rrjedhimisht sipas provave materiale të çështjes, rezulton se ankuesi sipas Akt Emërimit të datës 12.07.2016 është i punësuar në kuadër të Agjencisë së Shoqërisë së Informacionit, e për rrjedhojë referuar Ligjit Nr. 04/L-145 për Organet Qeveritare për Shoqërinë e Informacionit, sipas nenit 5 paragrafi 1, është përcaktuar: *1. Agjencia për Shoqërinë e Informacionit (në tekstin e mëtejme: Agjencia) themelohet si agjenci ekzekutive qeveritare në kuadër të ministrisë përgjegjëse për administratë publike, apo në organin e lartë pasuese të administratës shtetërore që vendos Qeveria, ndërsa me nenin 7 të këtij ligji, është përcaktuar: 1. Agjencia udhëhiqet nga Drejtori i përgjithshëm, i cili emërohet në pajtim me rregullat dhe procedurat për emërimin e pozitave të larta drejtuese në Shërbimin civil të Republikës së Kosovës. 2. Drejtori i përgjithshëm i Agjencisë është përgjegjës për: 2.1. administrimin dhe menaxhimin e përgjithshëm të Agjencisë dhe garantimin e zbatimit të funksioneve, që i janë besuar Agjencisë; 2.2. ofrimin e udhëzimeve të sakta e të paanshme dhe këshillave profesionale për institucionet e Republikës së Kosovës në fushën e TIK-ut; 2.3. menaxhimin efikas të burimeve njerëzore dhe financiare me të cilat disponon Agjencia, si dhe 2.4. zbatimin e përgjegjësive të tjera në mënyrë analoge me përgjegjësitë e Sekretarit të përgjithshëm të ministrisë, siç është përcaktuar me Ligjin për Administratën Shtetërore. Pra nga ky këndvështrim sipas dispozitave të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, konkretisht nenit 22 dhe 23 ku është përcaktuar se : **Neni 22:** 1. Agjencia Ekzekutive drejtohet nga drejtori ekzekutiv. 2. Drejtori ekzekutiv i Agjencisë është nëpunës civil i kategorisë së lartë drejtuese sipas ligjit për zyrtarët publikë. 3. Drejtori ekzekutiv për performancën dhe veprimtarinë e Agjencisë, i përgjigjet ministrit dhe informon Sekretarin e Përgjithshëm”, **Neni 23:** 1. Drejtori ekzekutiv drejton dhe përfaqëson Agjencinë dhe në mënyrë të veçantë është përgjegjës për : 1.1. propozimin e planit dhe raportit vjetor të performancës të Agjencisë; **1.2. menaxhimin e burimeve njerëzore të Agjencisë në pajtim me ligjin për zyrtarët publikë;** 1.3. ekzekutimin e buxhetit dhe miratimin e pagesave sipas legjislacionit për menaxhimin e financave publike; 1.4. lidhjen e kontratave në emër dhe për llogari të institucionit, në pajtim me ligjin; 1.5. menaxhimin e pronës shtetërore, që i është besuar Agjencisë për administrim. 1.6. çdo përgjegjësi tjetër që i caktohet me ligj, Kolegji i Këshillit, konstatoi se Agjencia për Shoqërinë e Informacionit është agjenci ekzekutive në kuadër tashmë të Ministrisë për Digjitalizim dhe Administratë Publike, ndërsa në kohën e transferimit të ankuesit ka qenë në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, e cila siç është thekuar më lartë udhëhiqet nga Drejtori i Përgjithshëm si nëpunës më i lartë administrativ dhe se i njëjti përveç tjerash ka kompetenca në menaxhimin e burimeve njerëzore të këtij institucioni dhe ndërmarrjen e çdo veprimi për të cilën është i autorizuar me ligj,*

ndërsa, po ashtu edhe institucioni ku është transferuar ankuesi pra Agjencia e Regjistrimit Civil sipas Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, është agjenci ekzekutive në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Marr parasysh dispozitat ligjore të cekura si më lartë dhe konstatimet e dhëna si më lartë, rezulton se ankuesi nuk është i emëruar në Ministrinë e Punëve të Brendshme, por sipas Akt Emërimit është i emëruar në kuadër të Agjencisë së Shoqërisë së Informacionit, dhe mbi këtë bazë Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Brendshme lidhur me transferimin e përkohshëm për interes të institucionit, mundet vetëm të punësuar në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme t'i transferoj në agjenci ekzekutive të Ministrisë së Punëve të Brendshme, por nuk ka mandat që nga një agjenci të bëjë transferimin në një agjenci tjetër çoftë ato edhe agjenci në kuadër të ministrisë së njëjtë, sepse vetë neni 63 paragrafi 2 nën paragrafi 2.2 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, përcakton se: *Transferimi mund të bëhet: 2.2. në një agjenci ekzekutive të institucionit ku është emëruar, pra sipas kësaj norme vetëm nga Ministria e Punëve të Brendshme mund të bëhet transferimi në një agjenci në kuadër të kësaj Ministrie e jo si në rastin konkret që ka ndodhur me transferimin e ankuesit, ndërsa në rastin konkret ka mundur të zbatohet neni 4 paragrafi 3 i Rregullores (QRK) Nr. 02/2024 për Transferimin e Nëpunësve Civilë.*

Kolegji i Këshillit, bazuar në të gjeturat dhe konstatimet si më sipër, e në mbështetje të nenit 88 dhe 89 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet: *“Neni 88 1. Organi publik, për të përcaktuar gjendjen e fakteve dhe rrethanat e ndërlidhura me çështjen, mund të përdorë çdo mjet prove të paraparë nga ligji për procedurën kontestimore. 2. Faktet tashmë të njohura për organin publik, faktet e njohura botërisht apo faktet e prezumuara me ligj, nuk kanë nevojë të provohen. Neni 89 Organi publik vlerëson, sipas bindjes së tij, se cilat fakte do të konsiderohen të provuara, bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veçmas dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ”,* konstaton se akti i kundërshtuar me ankesë respektivisht Vendimi me Nr.2402/2025, i datës 31.12.2025, i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme, cilësohet si veprim i ndërmerr nga personi jo kompetent, dhe si e tillë është akt i paligjshëm në kuptim të nenit 52, paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që i njëjti është anuluar si në dispozitiv të këtij vendimi, andaj edhe pretendimet e ankuesit ndaj këtij vendimi janë të bazuara, andaj Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Brendshme, është i obliguar që në pajtim me dispozitivin dhe arsyetimin e këtij vendimit, të ndërmarr të gjitha veprimet që ankuesi të kthehet në vendin e punës sipas akt emërimit.

Kështu që, për sa me sipër dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur, e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
LËNDA, A.nr.103/2026

Ilire Mehmeti-Shaqiri

Procesmbajtëse

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit Z.R;
- Sekretarit të Përgjithshëm dhe Udhëheqësit të Njësisë së Burimeve Njerëzore në MPB; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.